



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GAZETARISË DHE KOMUNIKIMIT



Programi: Bachelor

Drejtimi: Gazetari

Lënda: Albanologji

Pedagogu: Prof. Asoc. Dr. Linda Mëniku
Ngarkesa: 2 ETCS (15 javë: 1.5 leksione në javë)
Lloji i lëndës: me detyrim
Viti/semestri: II/II

Përshkrimi:

Lënda „Albanologji“ është hartuar me synimin për të formuar studentët me njohuritë bazë për historinë e gjuhës shqipe, si një nga elementet më të rëndësishme të identitetit të tyre si shqiptarë. Kjo lëndë synon që të informojë në mënyrë shkencore jo vetëm studentët shqiptarë, por dhe studentët e huaj për prejardhjen e gjuhës shqipe dhe rrugën e zhvillimit të saj deri në procesin e standardizimit. Në këtë lëndë do të trajtohen tezat e ndryshme në lidhje me prejardhjen e gjuhës shqipe, dokumentet e para në gjuhën shqipe, si dhe ngjarje të tilla me një rëndësi historike si Kongresi i Manastirit apo Komisioni Letrar e Shkodrës.

Krahas marrjes së informacionit për momentet më themelore të historisë së gjuhës shqipe, studentët do të kenë mundësinë të njihen dhe me kontributin e figurave më të shquara në fushën e albanologjisë.

Lënda është e konceptuar si një cikël leksionesh për temat më të rëndësishme në lidhje me historinë e gjuhës shqipe.

Leksionet do të jenë ndërvepruese. Përmes pjesëmarrjes aktive të studentëve në leksione, synohet që përvetësimi i njohurive të realizohet në një masë të madhe gjatë orës së mësimi.

Studentët do të kontribuojnë përmes mbledhjes së informacioneve për figurat kryesore të albanologjisë dhe paraqitjes së këtij informacioni jo vetëm gjatë orës së leksionit, por dhe në formën e detyrave të kursit.

2. Temat e leksioneve

Java	Tema	Literatura
------	------	------------

1	Gjuhët indoevropiane.	E. Çabej, <i>Studime gjuhësore, III</i>
2	Klasifikimi i gjuhës shqipe si gjuhë indoevropiane dhe vendi i saj në këtë familje.	E. Çabej, <i>Studime gjuhësore, III</i>
	Fiset ilire. Shtrirja e tyre.	E. Çabej, <i>Studime gjuhësore, III</i>
3	Origjina e gjuhës shqipe. Teza ilire.	E. Çabej, <i>Studime gjuhësore, III</i>
4	Origjina e gjuhës shqipe. Teza trakase.	E. Çabej, <i>Studime gjuhësore, III</i>
5	Çështje të burimit të emrit shqiptar.	E. Çabej, <i>Studime gjuhësore, III</i>
6	Dokumentet e para të gjuhës shqipe	E. Çabej, <i>Studime gjuhësore, III</i>
7	(Formula e Pagëzimit-Fjalorthi i Arnold von Harfit)	E. Çabej, <i>Studime gjuhësore, III</i>
	Gjon Buzuku dhe vepra e tij “Meshari” (I)	
8	Gjon Buzuku dhe vepra e tij “Meshari” (II)	E. Çabej, <i>Shqipja në kapërcyell</i>
9	Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe.	E. Çabej, <i>Shqipja në kapërcyell</i>
10	Fjalori i Frang Bardhit	S. Riza, <i>Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe.</i>
	Gjuha shqipe dhe dialektet e saj.	
11		E. Çabej, <i>Studime gjuhësore, III</i>
12	Albanologë të njohur (E.Çabej, F.Bopi, N. Jokl, H.Pedersen, etj)	J. Gjinari -Gj. Shkurtaç, <i>Dialektologjia</i>
13	Kongresi i Manastirit	Autorë të ndryshëm
	Komisia Letrare e Shkodrës	
14		T. Osmani, <i>Udha e shkronjave shqipe</i>
15		T. Osmani, <i>Komisia letrare në Shkodër</i>

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi në:70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Detyra e kursit: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5.	10% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	80% e notës
- Gjithsej:	100%

Literatura e detyrueshme për studentin:

Çabej, E. “Hyrje në historinë e gjuhës shqipe”, Çabej, Tiranë, 2008.

Çabej, E. “Shqipja në kapërcyell”, Çabej, Tiranë, 2006.

Çabej, E. Studime gjuhësore, III.

Gjinari, J. “Dialektet e gjuhës shqipe”, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1989.

Osmani, T. “Komisia letrare në Shkodër”, Shkodër, 2005.

Osmani, T. “Udha e shkronjave”, Shkodër, 1999.

Riza, S. “Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe”. Toena, 2002.